

Kosovo Solutions
Sheshi Nënë Tereza
10000, Prishtinë
Republika e Kosovës

01 mars 2019, Prishtinë

Letër Motivimi

I/E nderuar,

Përmes kësaj letre shpreh interesin tim për të aplikuar për pozitën e [Menaxherit të Mediave Sociale] në kompaninë [Kosovo Solutions], sipas konkursit të shpallur në Portalin Kastori, më 15 shkurt 2019.

Jam i bindur se sukcesi im në pozitat e mëparshme si menaxher i mediave sociale, si dhe aftësitë e mia të komunikimit dhe të bashkëpunimit, më bëjnë një kandidat ideal për këtë pozitë.

Kam më se dhjetë vite përvojë pune profesionale në marketing dhe marrëdhënie me publikun, dhe në pesë vitet e fundit kam punuar si menaxher i mediave sociale. Fushata ime më e fundit për [Kosovo Consulting] mundësoi një rritje prej mbi 35% në trafikun përbrenda faqes së internetit. Përmes një kombinimi të strategjive marketingu kreativ të mediave sociale dhe monitorimit të suksesshëm të progresit përmes analizave të 'insights' dhe paneleve të kontrollit, unë mund t'i siguroj kompanisë tuaj një shkallë të ngjashme sukcesi.

Në punët e mia të mëparshme, si Koordinator i Marketingut për kompaninë [Sistemet Pioneer], kam udhëhequr fushata marketing, kam mbajtur takime të rregullta në të cilat kam paraqitur raporte të marketingut, analiza, dhe plane komunikimi.

Unë jam i bindur se përvoja ime, veçanërisht në fushën e marketingut, si dhe aftësia ime për të bashkëpunuar dhe për të komunikuar, më bëjnë një kandidat të fortë për Menaxherin e mediave sociale në Kosovo Solutions. Ju lutem gjeni të bashkëngjitur CV-në time dhe shpresoj që të kemi mundësinë të gjejmë një kohë të përshtatshme për të biseduar së bashku.

Faleminderit shumë për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,
[Emri mbiemri juaj]